



Viti i XVI-të i Botimit, Nr.1

Qershor 2024

NDIKIMI I COVID-19 NË ZGJERIMIN E GJASHTË VENDEVE TË BALLKANIT PERËNDIMOR

Vasilika Papa*

**Albanian University*

Abstrakt

Gjashtë vendet e Ballkanit Përndimor që aderojnë të jenë pjesë e Bashkimit Evropian janë: Serbia, Maqedonia e Veriut, Shqipëria, Mali i Zi, Bosnja dhe Hercegovina dhe Kosova. Këto vende kanë aplikuar prej kohësh dhe janë ende në pritje për të qenë anëtarë të BE-së. Kriza e Covid-19 u shkaktua nga përhapja e pandemisë nga Kina në Evropë duke dëmtuar rëndë ekonominë e të gjithë vendeve të Evropës. Si pasojë e krizës së Covid-19 u dëmtuan edhe në ekonominë e brishta të gjashtë vendeve të Ballkanit Përndimor. Ato nuk morën asistencë mjekësore apo financiare nga BE në kohën e duhur, gjë që shkaktoi skepticizëm në këto vende të cilat mendonin se BE-ja nuk është lider në botë pasi nuk mund t'i ndihmonte dhe të menaxhonte në kohë krizën e Covid-19. Kjo krizë ishte një nga shkaqet kryesore të procesit të zgjatuar të integritetit pasi BE-së iu desh të përballlej me problemet e brendshme për të zgjidhur krizën brenda shteteve anëtare të BE-së duke bllokuar procesin e integritetit.

Metodologjia: Metodologjia e përdorur në këtë studim është kërkimi cilësor në të cilin analizohen qasjet dhe qëndrimet e ndryshme që studiuesit kanë mbajtur në lidhje me pasojat e krizës Covid-19 përse i përket procesit të integritetit të gjashtë vendeve të Ballkanit Përndimor.

Qëllimi: Të identifikojë pasojat e krizës së COVID në gjashtë vendet e Ballkanit përndimor përse i përket procesit të tyre të integritetit evropian.

Konkluzion: Duke qenë se gjashtë vendet e Ballkanit përndimor patën ndihmë nga BE-ja por më vonë nga vendet e tjera, vendet e Ballkanit u zhgënjyen nga BE-ja. Në të njëjtën kohë kriza e Covid-19 shkaktoi vonesa në procesin e integritetit e cila shkaktoi rritjen e euroskepticizmit në këto vende.

Fjalë çelës: *krizë, pasoja, pandemi, proces integriteti, problem të brendshme, euroskepticizmi.*

IMPACT OF COVID-19 CRISIS IN THE SIX WESTERN BALKAN COUNTRIES

ENLARGEMENT

Abstract

The six Western Balkan countries striving to be part of the European Union are: Serbia, North Macedonia, Albania, Montenegro, Bosnia and Hercegovina and Kosovo. These countries have applied a long time ago and are still waiting to be members of the EU. Covid-19 crisis was caused by the spreading of the pandemic from China to Europe having devastated the economies of the whole Eu-

rope. As a consequence of the Covid-19 crisis affected also the fragile economies of the six Western Balkan countries. They did not receive medical or financial assistance from the EU in due time which caused scepticism in such countries whose perception was that EU is not a leader in the world as they could not manage in time the whole Covid-19 crisis. This crisis was one of the main causes of the prolonged integration process as the EU had to deal with internal problems in order to solve the crisis within the EU Member States.

Method: The methodology to be used in this study is the qualitative research in which will be analysed different approaches and positions that researchers have taken in regard to the consequences of the Covid-19 crisis in relation to the six Western Balkan countries integration process.

Objective: To identify the consequences of COVID crisis in the six Western Balkan countries in relation to their EU integration process.

Conclusion: As the six western Balkan countries received assistance from the EU but it was later than the other countries, they were disappointed from the EU. At the same time Covid-19 crisis caused rising Euroscepticism in such countries.

Key words: *crisis, consequences, pandemic, integration process, internal problems, Euroscepticism.*

Hyrje

Pandemia e Covid-19 nisi në vitin 2019 në Kinë dhe vazhdoi edhe në vitin 2020 duke u përhapur shpejt në të gjithë Evropën duke shkaktuar një numër të madh vdekjesh të shoqëruara me mjaft problematika të tjera negative. Bashkimi Evropian u gjend i papërgatitur për të përballur çështje të papritura dhe emergjente sic ishte Covid-19. Gjatë krizës së pandemisë të gjitha vendet anetare të BE-së u përqëndruan në problemet e tyre të brendshme për të cilat ishin të papërgatitur. Vendet e Ballkani perëndimor ishin në situatë mjaft të vështirë gjatë kësaj periudhe pasi ekonomia e tyre pësoi rënie të menjëhershme dhe nuk kishin burimet të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet spitalore për blerjen e pajisjeve dhe medikamenteve. Bashkimi Evropian bllokoi kufinjtë si dhe nuk ishte i gatshëm të ndihmonte këto vende. Disa nga pasojat kryesore në vendet e Ballkanit perëndimor ishin pasojat negative në ekonomi, rritja e ndikimit të aktorëve të tretë në Ballkan si Rusia, Kina dhe Turqia të cilët e shfrytëzuan këtë rast për interesat e tyre gjeopolitike. Gjithashtu ndikoi në rritjen e euroskepticizmit dhe mosbesimit ndaj Bashkimit Evropian si dhe në bllokimin e hapjes së negociatave me Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë në 2019. Megjithatë drita jeshile për hapjen e negociatave me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut u dha me 25 mars të vitit 2020, këtyre vendeve iu deshën të prisnin gjatë derisa morën një përgjigje pozitive.

1.1 Pasoja në ekonominë e vendeve të Ballkanit Perëndimor

Një nga pasojat me ndikim të menjëhershëm ishte ndikimi në ekonomi. Duke qënë se ekonomia e vendeve të Ballkanit perëndimor janë mjaft të lidhur me ekonominë e vendeve të Bashkimit Evropian, ndikimi në ekonominë e tyre të brishta ishte i ndjeshëm. Sipas tabelës 1, rritja e PBB-së ishte mjaft negative për këto vende duke iu referuar vitit 2020.

Tabela 1

Vendet e Ballkanit Perëndimor	Shqipëria	Bosnia and Hercegovina	Kosova	Mali i Zi	Maqedonia e Veriut	Serbia
Rritja e PBB në %	-3.3	-4.5	-3.9	-15.2	-4.5	-1.0

Burimi: OECD 2021, f. 33

Ishin disa problematika në ekonomi që dolën në pah gjatë periudhës së pandemisë. Të gjitha vendet evropiane duke përfshirë Vendet Anëtare të BE-së u ndikuan nga pandemia për shkak të mbylljes së kufinjve gjë që shkaktoi humbje të mëdha. Sektori i eksportit pësoi humbje të mëdha me mbylljen e kufinjve, në turizëm me mbylljen e të gjitha fluturimeve dhe njerëzit nuk lejoheshin të udhëtonin në shumë vende të Evropës. Me falimentimin e shumë bizneseve papunësia rezultoi në rritje në Shqipëri me 12.2%, Bosnjë dhe Hercegovinë 18%, Kosovë 25.7%, Mali i Zi 18.4%, Maqedonia e Veriut 16.4% dhe Serbia 9.0%. (OECD, 2021). Vlera e monedhave si edhe investimet publike dhe private në vendeve të Ballkanit Perëndimor pësuan rënie. Probleme të tjera rezultuan në shëndetësi sic janë stafi mjekësor nuk ishte i përgatitur të përballlej me një sfidë të tillë dhe nuk kishte burime të mjaftueshme financiare për të mbuluar humbjet ekonomike. Gjithashtu duhet të theksohet edhe fakti se në vendet e Ballkanit perëndimor nuk merrnin me remitanca nga emigrantët që jetonin në vendet e anëtare të Bashkimit Evropian pasi kishin rënie të ndjeshme të të ardhurave të tyre. Ndërsa të gjitha vendet anëtare të BE-së ishin të zëna të mëkëmbnin ekonominë e tyre, ata nuk kishin kohë apo strategji specifike për të ndihmuar gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor.

Ambasadorja Susanne Schütz (Director for South-Eastern Europe, Turkey, OSCE and Council of Europe German Federal Foreign Office) thekson faktin se vendet e Ballkanit perëndimor përjetuan faktin të mos qenit një vend anëtar i Bashkimit Evropian. Së pari, kufizimet e eksporteve të BE-së për pajisjet mbrojtëse personale u aplikuan në rajon. Kjo nuk i la vetëm këto vende të pashpresë por gjithashtu riafirmoi ndjenjën se nuk janë pjesë e Evropës. Vetëm pas përpjekjeve të mëdha nga qeveritë e Ballkanit perëndimor dhe dërgesave të pajisjeve mjekësore nga Rusia, Turqia dhe vecanërisht Kina ndaj Ballkanit perëndimor, BE-ja vendosi t'i hiqte kufizimet rajonit dhe e përfshiu rajonin në aktivitetet e përbashkëta të prokurimit. (Aspen Institute, 2020)

Kriza e Covid 19 nxorri në pah se sistemet shëndetësore nuk ishin të përgatitur të përballen me një krizë të atillë dhe se kishte mungesë të stafit mjekësor të specializuar dhe të pajisjeve. Ata që kishin më shumë pasoja negative ishin gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor të cilët në fakt shprehen shqetësimin e tyre kur BE-ja kufizoi eksportin e pajisjeve mjekësore jashtë bllokut.

Disa komentatorë kanë sugjeruar se kjo shënon vdekjen e integritetit evropian dhe madje edhe vëzhguesit më optimistë e kanë pranuar atë si një nga sfidat më të mëdha që BE-ja është përballur përse i përket menaxhimit të krizës dhe të treguarit të vlerave të shtuara supranacionale. (Russack, 2020 P. 1). Komisioni Evropian dhe disa shtatë anëtarë kanë vënë në dukje nevojën për reforma të brendshme të BE-së në drejtim të sfidave demokratike në vend, si dhe shqetësimet rreth largimit nga demokracia në Vendet e Ballkanit. Kjo ka bërë që procesi i integritetit të jetë më kërkuar duke krijuar një situatë ku “perspektiva e hyrjes në BE e vendeve të Ballkanit perëndimor dhe zhvillimeve të brendshme të BE-se të jenë po aq të lidhura ngushtë sa edhe kanë qënë”.

Duhet theksuar se shëndetësia nuk është një kompetencë direkte e BE-së por një kompetencë e cila qëndron në vendet e BE-së. Për shkak të këtij kushti të gjitha vendet anëtare të BE-së u përqendruan në mbylljen e kufinjve të tyre dhe u morën kryesisht të menaxhonin dhe të jepnin kujdes shëndetësor në vendin e tyre dhe nuk mund të ndihmonin 6 vendet e Ballkanit perëndimor. Këto të fundit u lanë në mëshirë të vendeve jo anëtare të BE-së të cilat përfituan për ta kthyer situatën e tyre në përfundim e tyre gjeopolitik duke shkaktuar euroskepticizem përse i përket bashkëpunimit të BE-se në rastin e situatave të paparashikuara sic ishte kriza e Covid-19.

1.2 Rritja e ndikimit të aktorëve të tretë në Ballkan

Aktorët e tretë në Ballkan si Kina, Rusia dhe Turqia e përdorën faktin e mos dhënies së ndihmës nga BE-ja në vendet e Ballkanit për interesat e tyre për rritjen e ndikimit të tyre në këto vende duke ofruar ndihmë mjekësore dhe financiare.

Kina; zhvilloi një “diplomaci maskë” në periudhën e Covid-19 dhe ishte vendi i vetëm që tregoi të

ishte histori suksesi në menaxhimin e pandemisë dhe dërgoi mjekime dhe vaksina për vendet e Ballkanit. (Aspen Institute, 2020) Sipas Demitar Bechev “për Kinën ishte një mundësi e artë të turpëronte BE-në dhe perëndimin”. Vuksanovic tha: “është një mënyrë e mirë për të detyruar dhe ndikuar që BE të bëjë më shumë”. Kina nuk ishte i vetmi vend që i dha mbështetje gjashtë vendeve të Ballkanit perëndimor në fazën fillestare të pandemisë por gjithashtu Rusia, Hungaria, UAE dhe Turqia, shpesh të mirëpritur me ceremoni të vecantë dhe me bujë të madhe në shtyp. Ndihma e dhënë nga BE-ja më pas megjithëse i akordoi një shumë mjaft të madhe nuk u vlerësua dhe nuk u prit në të njëjtën mënyrë si donatorët e tjerë.

Rusia; shfrytëzoi rastin për të shpërndarë informacione të rreme për NATO dhe Bashkimin Evropian duke thënë se prodhuesit e vaksinave perëndimore ishin të korruptuar dhe se Bashkimi Evropian është i dobët dhe i pavendosur. (Aspen Institute, 2020)

Turqia; Turqia dha mbështetje për shkak të historisë dhe kulturës së përafërt sidomos për vendet me popullsi muslimane dhe e përdori mbështetjen e dhënë në Ballkanin perëndimor si mjet propagandë për promovimin e presidentit. (Aspen Institute, 2020)

Covid-19 inkurajoi Kinën dhe Rusinë, tashmë aktive në Ballkan të përpiqen për të mbushur hendekun e zgjerimit gjeopolitik duke ofruar ndihmë dhe investime si dhe raportime falso dhe keqinformim për Bashkimin Evropian. Mediat pro-Ruse e përshkruan ndihmën e BE-së si përpjekje të vonuar për të arritur mbështetjen ruse dhe kineze. Vihen re përhapja e thashethemeve për kolapsin e afërt të BE-së për shkak të dështimit të saj për t'u marrë me pandeminë, egoizmin e Bashkimit në veprimet e tij të jashtme dhe shfrytëzimin e krizës për të çuar përpara interesat e veta. Në të kundërt, këto burime i portretizojnë Rusinë dhe Kinën si fuqitë e vetme të besueshme gjatë krizës dhe si shpëtimtarë që ndihmuan Italinë dhe Serbinë ndërsa BE-ja ishte e shqetësuar.

1.3 Rritja e euroskepticismit

Deklarata nga liderë politikë në Serbi i përforcoi këto fakte, duke krijuar pretendime se vendi përfiton më shumë nga lidhjet me Kinën dhe Rusinë ashtu si BE-në. Presidenti Aleksandar Vučić e quajti solidaritetin evropian “një përrallë me mbret” dhe tha se Kina ishte vendi i vetëm në gjendje të japë ndihmë të madhe Serbise në krizë. Postera të presidentit Xi Jinping dhe flamuj kineze u valëvitën në Beograd për disa javë. Imazhe të mbledhjes së Kryeministres Ana Brnabić duke takuar avionin e parë nga shtatë avionët ruse që mbanin furnizime u transmetua live në televizionin serb. Media e monitoruar nga SCTA tregon se ndërmjet mars dhe maj 2020, artikujt e lajmeve serbe rreth Kinës u bënë më pozitive dhe artikujt rreth BE-së më negative. Televizioni shtetëror serb paraqiste në dritë negative BE-në, ndërsa e përshkruan pozitivisht Kinën dhe Rusinë. Por reagimet kanë qënë të ndryshme në Ballkan. Disa vende vecanërisht Kosova, kanë qënë më pak euforike rreth ndihmës nga Kina dhe Rusia dhe më mirënjohëse ndaj ndihmës së BE-së dhe SHBA-së. Shqipëria dhe Kosova mbeten vendet më pro-BE-së, por kryeministri Edi Rama e kritikoi hapur atë për mosdhënien në kohë të ndihmës mjekësore dhe ekonomike nga BE-ja.

Në gjashtë vendet e Ballkanit perëndimor u vu re rritja e euroskepticismit i cili rezultoi me këto të dhëna si mëposhtë: Maqedonia e Veriut; Sipas Sondazheve të Eurobarometër të 2019-ës, 57% e popullsisë tregoi besim ndaj BE-së me një përqindje në rënie në 51% në vjeshtë. Imazhi pozitiv i BE-së tregoi rënie nga 56% në 52%. (Eurobarometer, 2019) Në Malin e Ri gjatë 2019 dhe 2020, këto të dhëna pësuan rënie nga 55% dhe 54% (Political public opinion of Montenegro, 2020). Anëtarësimi i Serbisë është dicka e mirë sipas 42% e qytetarëve, ndërsa 22% prej tyre besojnë se është dicka e keqe. Bosnia and Hercegovina. Në një sondazh të 2020 nga European Integration Office e Bosnjës, 75 përqind e qytetarëve thanë se janë pro integritimit evropian. 10 vite më parë, kjo shifër ishte 85%. Besimi i Shqipërisë në BE ra me 4% në 2021, nga 75% në 2020, sipas sondazhit Besimi në Qeveri

të kryer nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim. (NDI, 2021) Qytetarët e Kosovës nëse BE është gjë e mirë për ekonominë e tyre në vitin 2018 shprehen “po” 84%, 2019 rezulton në 69% dhe në vitin 2020 në 75%.

1.4 Bllokimi i negociatave

Kriza e Covid-19 pati ndikim të ndjeshëm edhe në procesin e negociatave të vendeve të Ballkanit perëndimor me BE-në gjë që rezultoi në bllokimin e negociatave nga Presidenti francez Emanuel Makron i cili bllokoi hapjen e negociatave për anëtarësim për Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë në tetor 2019. Ky vendim u ndryshua në mars 2020 me vendim të Këshillit. Përsa i përket vendeve të tjera të Ballkanit perëndimor, nuk patën ndryshime, mbetën në të njëjtin stad përgjatë krizës së Covid-19 megjithë përpjekjet për përmbushjen e kushteve, pritshmëritë dhe premtimet që iu ishin dhënë nga Bashkimi Evropian.

Disa studiues komentojnë se kjo përforcoi idenë në vendet e Ballkanit perëndimor se BE-ja është e dobët e përqendruar në vetvete dhe se i ka kthyer shpinën vendeve të Ballkanit perëndimor. Sipas Bonomi, pandemia padyshim forcoi më shumë nevojën për axhendë të përbashkët ndërmjet BE-së dhe Ballkanit Perëndimor dhe emergjenca për ta përfshirë atë në përgjigje të përbashkët të BE-së ndaj pandemisë. (Bonomi 2020)

Konkluzion

Shëndetësia duhet të jetë çështje parësore për BE-në, duhet të merren masa të mëtijshme jo vetëm nëpërmjet politikave të ndërmarra por edhe në rastet e papashikuara të emergjencave shëndetësore me rëndësi jetike. Këto masa duhet të sigurojnë jo vetëm vendet anëtare të BE-së por edhe vendet e Ballkanit perëndimor duke mbajtur një buxhet të vecantë vetëm në funksion të emergjencave shëndetësore. Rezultatet e krizës së Covid-19 duhet të shërbejnë si mësim të vlefshme për të ardhmen në mënyrë që vendet më të brishta si vendet e Ballkanit perëndimor të mos jenë në syrin e ciklonin në raste krizash por të jenë të mbrojtura nga Bashkimi Evropian duke qenë se përpjekjet e bëra për e reformave dhe përmbushjen e kushteve janë maksimale. Përsheptimi i integritetit evropian mbetet një prioritet kyç që kërkohet me ngulm nga vendet dhe qytetarët e vendeve të Ballkanit perëndimor. Kjo do të shmangete euroskepticizmin e këtyre vendeve si dhe ndikimin e aktorëve të tretë në Ballkanin perëndimor.

Referencat

1. Russack, S. 20 April 2020 EU crisis response in tackling Covid-19, Views from the member states, European Policy Institutes Network
2. NDI, 2020, Political public opinion of Montenegro
3. Bonomi M. October 2020 EU ENLARGEMENT IN SOUTHEAST EUROPE IN PANDEMIC TIMES ANALYSIS (Rome), Albana Merja (Tirana), Theresia Töglhofer (Berlin) and Dušan Reljic (Brussels)
4. Džihic V. and S. Marta, 2021, Bringing citizens into the fold – Making EU enlargement work in the (post) Covid-19 world
5. Aspen Institute, 2020, The Covid-19 pandemic in the Western Balkans: consequences and policy approaches
6. OECD (2021), “Economic context”, in Competitiveness in South East Europe 2021: A Policy Outlook, OECD Publishing, Paris.
7. NDI, 2021, Besimi në Qeveri, sondazhi i opinionit publik
8. Standard Eurobarometer, 2019, Autumn 2019-December 2019



SHKENCAT SHOQËRORE

SEKSIONI 2

